

## **RAPORT VJETORI SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE TË QKMF – PRISHTINË 2014**

QKMF në Komunën e Prishtinës rëndesi të veçantë i jep ngritjes së cilësisë dhe kualitetit të punës .

Andaj si pikë strategjike synon në:

- Reduktimin e pabarazisë së cilësisë të shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore;
- Papranueshmërinë e variacioneve në rezultatet shëndetësore të pacienteve të trajtuar ;
- Përdorimi i teknologjive efikase shëndetësore;
- Reduktimin e pakënaqësisë së pacienteve gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe
- Pakënaqësisë së punonjësve me sistemin e kujdesit shëndetësor; Komisioni për ngritjen e cilësisë ka bërë në mënyrë kontinuele përcielljen e punës së punëtorve shëndetësor, bashkëpunon me menaxhmentin, kolegjiun profesional dhe me punëtorët shëndetësor të QKMF.

Sipas analizës të treguesve për kualitetin e punës për vitin 2014, si dhe analizës së anketimit të kënaqshmërisë së pacienteve , tregon se ka një arritje të kënaqshme të këtyre qëllimeve.

- Sipas raportit vjetorit 2014 në QKMF gjithësejtë ka pasur 934661 vizita mjekësore , kurse totali i të gjitha shërbimeve shëndetësore ka qenë 2078524 shërbime. Krahasuar me të njëjtë periudhë kohore e të vitit paraprak këto shërbime janë rritur për 7 %. Numri mesatar për një mjekë familjar është 4076 vizita mjekësore,
- Gjatë kësaj periudhe **Laboratorët** e QKMF numri i pacienteve që kanë bërë **ekzaminime laboratorike ka qenë 74558 3% me tepër se në vitin paraprak 2013.**  
Në këtë kohë janë krye **31712 Inqizime Radiologjike**, ndërsa **Shërbime tjera Shëndetësore** janë krye gjithësejt **476556** shërbim.

- Vizita **Stomatologjike** kane qene 69028 12% me shume vizita se ne vitin 2013. Shërbime në këtë periudhë janë kryer si vijon: **dhëmb të bllobuar 11554, intervenime kirurgjike 17218**(extrakcion I dhëmbit), punë **protetike** te **171** raste , shërbime **ortodontike 2759**dhe **mjekim i indeve të buta 3701** shërbime.
- Në këtë vit shërbimi i vaksinimit duke u nisur nga planifikimi për këtë periudhë kanë arritur këto rezultate: **Polyo** vakcina **97%**, **DTP-Hib-HB 97%**, **BCG-100%** dhe **MMR-89%**. Poashtu është aplikuar edhe vakcina e **Gripirt** sezonal dhe atë **7746** doza.
- Bashkëpagesat në shërbimet shëndetësore gjatë kësaj periudhe kanë qenë të realizuara te **174574 pacient**, që krahasuar me vitin 2013 bashkëpagesat janë rritur për **6 %** bazuar në numër të pacientëve.
- Bazuar në plan programin e Shëndetit Publik të QKMF në Prishtinë në bashkpunim me DDKSHMS u organizuan Vizitat Sistematike të nxënësve të klasëve të I dhe të V. të Shkollave Fillore të Komunës së Prishtinës prej dates 10.05.2014 deri më 09.06.2014. Në këto vizita u përfshinë gjithësejtë **6899** nxënës, prej tyre **3418** nxënës të klasve të para dhe **3481** nxënës të klasve të V.
- Pas vizitave të kryera sistematike është bërë analiza për të gjitha të gjeturat dhe u përgatit një prezentim në detale ku kishte për qëllim që me të dhënat e nxjeruna të njoftohen të gjitha ekipet implementuese të vizitave sistematike. Për këtë qëllim DDKSHMS organizoi një seminar dy ditor në Shën Gjirinë-Shqipëri. Në këtë seminar u prezentuan “ Rezultatet e Vizitave Sistematike”, Auditi mbi “Aplikimi i antibiotikëve parenteral”, “Menaxhi i Emergjencave në QMU”, u bë prezentimi i projektit “ Fëmijë të vegjel buzëqeshjet të mëdha” si dhe prezentimi i temës :” Menaxhimi dhe metodat e menaxhimit”.

- Vlenë të thekësohet se në bazë të suksesit të vizitave sistematike Drejtori i DKSHMS me angazhimin e tij realizoj donacionin nga Ambasada Çeke ku është bërë paisja me laptop (15) për ekipet implementuese të vizitave sistematike si dhe është siguruar një program për futjen e të dhënave në mënyrë elektronike për këto vizita që janë planifikura të fillojnë në fillim të muajit Prill të 2015.
- Gjatë kësaj periudhe Shërbimi Shëndetit Publik në QKMF ka raportuar sëmundjet ngjitëse si dhe sëmundjet tjera jo ngjitëse në IKSHPK dhe ka patur në menaxhim gjithë situatën epidemiologjike në Komunë. Aktivitet i veçantë gjatë kësaj periudhe ishte edhe menaxhimi i rasteve të dyshimta me Parotit Epidemik . Për këtë qëllim u zhvilluan edhe disa aktivitete në disa shkolla të qytetit në bashkpunim me DDKSHMS. Me qëllim të njoftimit për ecurin e kësaj sëmundje është njoftuar edhe kolegji profesional i QKMF me një ligjëratë për sëmundjen dhe ecurin e rasteve të dyshimta në Parotiti Epidemik në Komunën e Prishtinës.
- Në këtë vitë u formua Komiteti për Promovim dhe Edukimin shëndetësor e që aktivitetet të parë shenoi në Ditën Botrore të **HIV/AIDS** me organizimin e ligjëratave në disa prej shkollave të mesme të qytetit, me qëllim të ofrimit të njohurive lidhur me këtë sëmundje për të rinjtë e këtyre shkollave.
- Gjatë kësaj kohe janë realizuar dhe projektet e Deratizimit, Dezinfektimit dhe Dezinfektimit të hapësirave të objekteve shëndetësore të QKMF. Dezinfektimi i objekteve është kryer në muajin Gusht(04.08.2014d deri 06.08.2014) dhe u përfshinë **15.261m<sup>2</sup>** të sipërfaqeve të objekteve shëndetësore , gjegjësisht **44** njësi të QKMF. Dezinfektimi dhe Deratizimi i hapësirave në objektet e QKMF është kryer në muajin Nëntor(04.11.2014 deri 08.11.2014)ku janë përfshirë gjithësejtë **16020 m<sup>2</sup>**.
- Gjatë këtij viti është krye transporti i pacientëve me Dijalizë sipas planit dhe orarit të hartuar nga QKUK -Njisija për Hemodializë sipas ndrimeve .

Ky transport i pacjentëve për Hemodializë është bërë gjatë gjithë javës në përjashtim të ditës së djelë . Numri i pacjentëve që janë transportuar për nevoja të hemodializës gjatë kësaj periudhe ka qenë **rreth 85** pacjentë.